

NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË “BANKA CREDINS” SH.A.

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Perfaqesues/e i/e Aksionerit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Hënë, datë 29 Qershor 2015, ora 14:00 në ambientet e “ BANKA CREDINS” SH.A., në adresën Rr. “Ismail Qemali” Nr. 4, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të “BANKA CREDINS” SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Miratimi i Pasqyrave Financiare vjetore te “Banka Credins” sh.a per vitin 2014 sipas IFRS.
2. Miratimi i Pasqyrave Financiare vjetore te “Banka Credins” sh.a per vitin 2014 sipas kërkesave te Bankës se Shqipërisë
3. Miratimi i Rezultatit Financiar te “Banka Credins” sipas IFRS dhe Bankës se Shqipërisë sh.a per vitin 2013.
4. Propozim per riemërimin e shoqërisë “Ernst & Young” si ekspert kontabël i autorizuar per auditimin e pasqyrave financiare per vitin 2015.
5. Propozim per miratimin e Buxhetit te shoqërisë “Banka Credins” Sh.a per vitin 2015 përgatitur sipas IFRS dhe Metodologjisë se Raportimit te Bankës se Shqipërisë.
6. Propozim per miratimin e Plan Biznesit te “Banka Credins” Sh.a per vitin 2015.
7. Propozim per miratimin e ekspertes kontabël te autorizuar Znj.Vera Fazlli Lala per vlerësimin e zmadhimit te kapitalit aksioner te shoqërisë “Banka Credins” Sh.a nëpërmjet kalimit te fitimit te pashpërndare te vitit 2014.
8. Ngarkohet Drejtoria te njoftoje Bankën e Shqipërisë dhe te beje regjistrimet përkatëse pranë QKR

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tiranë, më 08.06.2015

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»

- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.